



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 01/83
Datë: 11.01.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 janar 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen procesverbalet nga mbledhjet 79 dhe 80 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/83
Datë: 11.01.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011 dhe me Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2012 për procedurat, kriteret dhe metodologjinë e përgatitjes dhe miratimit të dokumenteve strategjike dhe planeve për zbatimin e tyre, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 janar 2019, nxjerr këtë:


V E N D I M

Për themelimin e Komisionit ndërinstytucional për shqyrtimin e Marrëveshjes gjithëpërfshirëse me Newdea Inc.

1. Qeveria e Republikës së Kosovës nëpërmjet Memorandumit të Mirëkuptimit të lidhur me Newdea Inc., të nënshkruar më 11 tetor 2018, ka shprehur gatishmërinë të krijoj partneritetet me Newdea Inc për të krijuar një platformë konvergjence e cila ofron një treg të unifikuar digjital për të stimuluar investimet dhe zhvillimin ekonomik në Republikën e Kosovës.
2. Komisioni ndërinstytucional do të ketë këtë përbërje:
 - 2.1. Këshilltari i Kryeministrit - kryesues;
 - 2.2. Zyra Ligjore, ZKM;
 - 2.3. Zyra për Planifikim Strategjik, ZKM;
 - 2.4. Ministria e Financave, Departamenti Ligjor;
 - 2.5. Ministria e Punëve të Jashtme, Departamenti për Çështje Ligjore dhe Traktate;
 - 2.6. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, KIESA;
 - 2.7. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Departamenti Ligjor;
 - 2.8. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave;
 - 2.9. Ministria e Administratës Publike, Agjencia e Shoqërisë së Informacionit;
 - 2.10. Agjencia e Statistikave të Kosovës;
 - 2.11. Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë.
3. Komisioni nga pika 2. e këtij vendimi është përgjegjës të përcaktoj mënyrat e angazhimit të Newdea për të zbatuar elementet e qëllimit të Memorandumit të Mirëkuptimit.
4. Komisioni gjithashtu autorizohet për të hartuar dhe negociuar një marrëveshje gjithëpërfshirëse që përfshinë kushtet e Memorandumit të Mirëkuptimit dhe kushtet tjera materiale.

5. Komisioni është i obliguar të informoj Kryeministrin e Republikës së Kosovës dhe të paraqes para Qeverisë së Kosovës rekomandimet lidhur me arritjen e Marrëveshjes gjithëpërfshirëse, para finalizimit të saj.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/83


Datë: 11.01.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 24.2 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 janar 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës i propozon Kuvendit të Republikës së Kosovës zgjatjen e ndarjeve buxhetore për muajin shkurt të vitit 2019 të përcaktuara me Ligjin Nr. 06/L-020 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që vendimin t'ia procedojë Kuvendit të Republikës së Kosovës për miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/83
Datë: 11.01.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 janar 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për themelimin dhe zbatimin e Funkcionit të Auditimit të Brendshëm në Subjektin e Sektorit Publik.
2. Obligohet Ministria e Financave dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 05/83
Datë: 11.01.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 janar 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Plotësohet dhe ndryshohet pika 3. e Vendimit të Qeverisë Nr. 02/80, datë 18.12.2018, si në vijim;
 3. Përbërja:
 - 3.1. Ministri i Mbrojtjes - kryesues;
 - 3.2. Këshilltar i Kryeministrit - zëvendës kryesues;
 - 3.3. Ministri i Punëve të Jashtme - anëtar;
 - 3.4. Ministri i Drejtësisë - anëtar;
 - 3.5. Ministri i Punëve të Brendshme - anëtar;
 - 3.6. Ministri i Integritimit Evropian - anëtar;
 - 3.7. Ministri i Financave - anëtar;
 - 3.8. Ministri i Infrastrukturës - anëtar;
 - 3.9. Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës - anëtar.
2. Pikat tjera të Vendimit Nr. 02/80, datë 18.12.2018 mbesin të pandryshuara.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/83

Datë: 11.01.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, duke shqyrtuar propozimin e Ministrisë së Administratës Publike, me nr. prot. 25, datë 08.01.2019, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 janar 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Z. Arsim Kuliqi, emërohet Kryeshf Ekzekutiv i Agjencisë së Kosovës për Eficiencë të Energjisë në kuadër të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik.
2. Mandati i të emëruarit nga pika 1. e këtij vendimi zgjatë 3 (tre) vjet.
3. I emëruari nga pika 1. e këtij vendimi i kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
4. Obligohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/83


Datë: 11.01.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, duke shqyrtuar propozimin e Ministrisë së Infrastrukturës, me nr. prot. 11121, datë 27.11.2018, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 janar 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Z. Eset Berisha, emërohet Drejtor i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës.
2. Mandati i të emëruarit nga pika 1. e këtij vendimi zgjatë 5 (pesë) vjet.
3. I emëruari nga pika 1. e këtij vendimi ushtron detyrat dhe përgjegjësitë në pajtim me legjislacionin në fuqi.
4. Obligohen institucionet përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/83

Datë: 11.01.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 janar 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Fushën e Administrimit të Resurseve Ujore.
2. Obligohet Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/83

Datë: 11.01.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, duke shqyrtuar kërkesën e Ministrisë së Administratës Publike, me nr. prot. 4165, datë 28.12.2018, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 janar 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Bazuar në Raportin e prezantuar në lidhje me akomodimin e institucioneve shtetërore, i lejohet Grupit punues që të vazhdojë punën në mënyrë që të paraqesë një propozim me kosto buxhetore për të gjitha opsionet e rekomanduara me qëllim të zgjidhjes së kësaj çështjeje.
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë